


Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti për
Shqipërinë
2022



monitoring
matrix

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti Përmbledhës për Shqipërinë 2022

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Maj, 2023



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Adresa: Rruga Maqedonia 43-1/9, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Nr. i tel.: +389 2 6144 211

Email: executiveoffice@balkanicsd.net

Faqe Zyrtare: www.balkanicsd.net
www.monitoringmatrix.net

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Adresa: Rruga e Elbasanit, Park Gate, Kati i 10-të, Ap. 71/73, Tiranë.

Nr. i tel.: +355 4 2254 881

Email: partners@partnersalbania.org
info@resourcecentre.al

Faqe Zyrtare: www.partnersalbania.org

Shkrimi i raportit:

Kostandina Këruti

Klotilda Kosta

Juliana Hoxha

Ky publikim u bë i mundur falë mbështetjes financiare të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Sida, dhe të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.

Përmbajtja

Përmbledhja Ekzekutive	7
Vështrim i përgjithshëm i shoqërisë civile	7
Gjetjet Kryesore	8
Rekomandimet Kryesore	9
Gjetjet	10
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive	10
Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit	10
Nën-fusha 1.2. Liritë e tjera	13
Fusha 2: Kuadri për Qendrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OJF-të	15
Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor/fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre	15
Nën-fusha 2.2. Mbështetja e shtetit	16
Nën-fusha 2.3. Burimet njerëzore	21
Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC	22
Nën-fusha 3.1. Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim	22
Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e vendimmarrjes dhe politikave	23
Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve	26
Referencat	28

Shkurtime

AAPSK	Agjencia per Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
BE	Bashkimi Evropian
CFCU	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DP	Deputet i Parlamentit
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KKIE	Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian
KKSHC	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
KM	Këshilli i Ministrave
LTF	Lufta kundër Financimit të Terrorizmit
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MM	Matrica e Monitorimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OGP	Partneritet i Qeverisjes së Hapur
PSK	Përgjegjësia Sociale Korporative
PSH	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

Përmbledhja Ekzekutive

Vështrim i përgjithshëm i shoqërisë civile

	2022
Numri i organizatave të regjistruara (+ sa janë të regjistruara në vitin 2022)	12,515 OJF 275 OJF të reja të regjistruara.
Ligjet kryesore të shoqërisë civile	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 8788 "Për organizatat jofitimprurëse". Ligji nr. 8989 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". Ligji nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".
Ndryshimet përkatëse në kuadrin ligjor	Ligj nr. 6/2022 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar. Ligj nr. 82/2022 ""Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 "për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë""", të ndryshuar. Ligj nr. 83/2022 ""Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2018 "Për procedurat tatimore të Republikës së Shqipërisë""", të ndryshuar.
Financimi shtetëror	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile 95milionë Lekë (rreth 795,000 Euro).
Burimet njerëzore	11.972 punëdhënës. Nuk ka të dhëna për vullnetarizmin.
Bashkëpunimi OJF-Qeveri (organi përkatës dhe i ri: mekanizmi konsultativ)	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile. Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian.
Sfidat kryesore	- Mungesa e të dhënave të unifikuara dhe të sakta për OJF-të. - Efektiviteti i bashkëpunimit OJF-Qeveri mbetet i ulët.

Gjetjet Kryesore

Gjetjet kryesore	
1.	Mungesa e regjistrimit elektronik për OJF-të nuk po kontribuon në një kuptim të qartë mbi madhësinë dhe vlerën ekonomike të sektorit dhe po e detyron sektorin të dyfishojë raportimin e tij për shkak të mungesës së integritetit të sistemeve të agjencive shtetërore.
2	Metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut të Financimit të Terrorizmit për sektorin e OJF-ve në Shqipëri u finalizua dhe pritët të kontribuojë në një qasje të bazuar në rrezik, të zbatuar nga agjencitë mbikëqyrëse të PPP/LFT për sektorin e OJF-ve.
3	Nisma të shpeshta, komplekse dhe jo domosdoshmërisht të përshtatura ligjore që ndikojnë në funksionimin e sektorit të OJF-ve, të pashoqëruara me ngritjen e duhur të kapaciteteve dhe kontaktimin (outreachin) e duhur nga institucionet shtetërore, kanë sjellë zbatim të dobët nga OJF-të, gjë që reflektohet në nivele të larta gjobash.
4	Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023, është zbatuar në nivele shumë të ulëta, duke treguar mungesë të angazhimit të Qeverisë dhe prioritet të ulët në këtë drejtim.
5	Informimi, konsultimi dhe pjesëmarrja kuptimplotë e OJF-ve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes vazhdojnë të jenë joefektive, pavarësisht legjislacionit në fuqi dhe mekanizmave të bashkëpunimit. Nisma e fundit ligjore për ndryshimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit paraqet shqetësime që tregojnë zvogëlimin e hapësirës për aktivizmin qytetar.
6	Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian nuk ka arritur ende të luajë rolin e parashikuar për informimin, konsultimin, komunikimin dhe përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e negociatave të anëtarësimit në BE, duke rezultuar në një numër dhe nivel të ulët të angazhimit të OJF-ve në këtë proces.

Rekomandimet Kryesore

Rekomandimet Kryesore	
1	Me krijimin e regjistrit të ri elektronik të OJF-ve, i cili pritet të jetë funksional në fund të vitit 2023, duhet të sigurohet integrimi i sistemeve të agjencive shtetërore për të shmangur raportimin e dyfishtë nga OJF-të dhe për të siguruar një kuptim të qartë për madhësinë dhe vlerën ekonomike të sektorit.
2	Riklasifikimi i sektorit të OJF-ve me “rrezik të ulët” për çështjet e PPP/LFT, duke ndryshuar kuadrin ligjor të PPP/LFT në këtë drejtim, mbështetur nga rezultatet e Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve ndaj Financimit të Terrorizmit në Shqipëri, të vitit 2022.
3	Shteti duhet të rrisë kontaktimin (outreach), kapacitetet njerëzore dhe teknike të institucioneve të tij dhe integrimin e sistemeve të agjencive shtetërore, për të siguruar informacion në kohë dhe asistencë efektive për OJF-të, në zbatimin e ligjeve të reja që ndikojnë në veprimtarinë e tyre.
4	Qeveria duhet të angazhohet seriozisht dhe të ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar zbatimin e masave të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023, brenda afateve të tij.
5	Qeveria duhet të konsiderojë me vëmendje plotësimin e mangësive institucionale për të siguruar struktura dhe kapacitete të duhura të administratës publike në mbështetje të proceseve konsultuese efektive dhe pjesëmarrjes së OJF-ve në proceset vendimmarrëse. Duhet të shqyrtojë me kujdes ndryshimet e propozuara në Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe çdo nismë tjetër ligjore për të shmangur tkurrjen e hapësirës qytetare.
6	Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian duhet të forcojë rolin e saj për të shërbyer si një mekanizëm bindës dhe për të mundësuar pjesëmarrjen e plotë të shoqërisë civile në tryezat e diskutimit dhe konsultimit për të gjithë kapitujt e acquis të BE-së.

Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive

Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit

1.1.1. Themelimi dhe pjesëmarrja në OJF

Në përgjithësi, legjislacioni është në përputhje me standardet në këtë fushë. Çdo person mund të themelojë organizata jofitimprurëse për çdo qëllim, sikundër çdo individ dhe subjekt ligjor mund të ushtrojë të drejtën e lirisë së organizimit pa diskriminim. Regjistrimi nuk është i detyrueshëm dhe ka rregulla të përcaktuara qartë lidhur me procesin e regjistrimit. Në bazë të ligjit nr. 82/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) miratoi Vendimin nr.35, datë 26.01.2022 “Për krijimin dhe funksionimin e regjistrit elektronik të organizatave jofitimprurëse”. Në bazë të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë krijohet regjistri elektronik, dhe funksionimi i tij fillon në datë 30 dhjetor 2023 (Fletore Zyrtare 17/2022). Ai do të krijohej në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 94, datë 9.02.2022 që përcakton rregulla të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore që regjistrohen në regjistrin elektronik të OJF-ve, rregulla të detajuara për ofruesit e informacionit, ndërveprimet me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesit për subjektet e interesuara (Fletore Zyrtare 23/2022). Përmbajtja e regjistrit elektronik nuk u konsultua me OJF-të.

Gjithsej janë **12,515 OJF**¹ të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë vitit 2022 janë regjistruar **275 OJF të reja**, nga të cilat 170 janë shoqata, 78 qendra dhe 27 fondacioneve, ndërsa **64 kërkesa për regjistrim janë refuzuar**² dhe 49 kërkesa u janë kthyer subjekteve kërkuese për rishikim. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT)³, janë **2,497 OJF me status aktiv**⁴.

Lidhur me aspektin praktik të regjistrimit, ai është pjesërisht në përputhje me standardet në këtë fushë, sepse regjistrimi nuk përmbush afatet dhe kostot e përcaktuara në ligj. Në bazë të përgjigjes së marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, koha mesatare e regjistrimit të një organizate nga dita e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit është **83 ditë**. Krahësuar me vitin e kaluar, ka një rritje të kohës mesatare të nevojshme për regjistrimin e një OJF-je nga 62 ditë në 83 ditë. OJF-të e regjistruara gjatë vitit 2022 raportojnë një kosto mesatare regjistrimi rreth 300 Euro. Nga vëzhgimi i disa dokumenteve të regjistrimit të OJF-ve, vihet re një neglizhencë në vendimin e gjyqtarit lidhur me

¹ Të dhëna të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në kërkesën e PSh.

² Gjykata nuk iu përgjigj kërkesës lidhur me arsyet e refuzimit.

³ Të dhëna të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bazuar në kërkesën e PSh.

⁴ Status aktiv nënkupton që organizata ka kryer aktivitete gjatë për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm.

dispozitat për konfliktin e interesit të përcaktuar në Ligjin e OJF-ve. Bazuar në këtë vëzhgim, disa vendime gjyqësore kanë pranuar që drejtori ekzekutiv i OJF-së të jetë njëkohësisht edhe anëtar bordi, gjë që bie ndesh me ligjin dhe standardin.

Kuadri ligjor mundëson krijimin e rrjeteve ndërmjet organizatave brenda dhe jashtë vendit pa njoftim paraprak. Nëse regjistrohen, rrjetet duhet të rregjistrohen në një nga format ligjore të lejuara nga ligji: qendër, shoqatë ose fondacion. Në një vëzhgim të kryer gjatë vitit 2022 nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, 83% nga 115 OJF-ve të anketuara janë anëtarë në të paktën një rrjet në nivel lokal, kombëtar, rajonal, Evropian dhe global.

1.1.2. Ndërrhyrja e Shtetit

Për sa i përket kuadrit ligjor, OJF-të janë autonome nga shteti dhe ligji garanton të drejtat e tyre për të vendosur mbi strukturën e tyre të brendshme dhe procedurat e funksionimit. Rregullat e raportimit financiar dhe të kontabilitetit marrin në konsideratë natyrën specifike të OJF-ve dhe janë në proporcion me madhësinë e organizatave (Fletore Zyrtare 171/2015).

Në janar të vitit 2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 6/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues përfundimtar””, të ndryshuar lidhur me shtyrjen e afatit për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese nga 30 në 40 ditë. Një tjetër ndryshim i rëndësishëm ishte rritja e të gjitha sanksioneve administrative lidhur me (1) vonesat në raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese të regjistruara në regjistrin përkatës, dhe (2) mosregjistrimin e ndryshimeve përkatëse për subjektet e regjistrimit që variojnë nga 50 mijë Lekë (420 Euro) deri në 600 mijë Lekë (5,000 Euro). Këto ndryshime parashikohen në nenin 13 “Sanksionet Administrative”. Për OJF-të, niveli i ri i gjobave është i lartë dhe vjen si përgjigje ndaj rekomandimit të MONEYVAL, sipas të cilit “*Shqipëria duhet të sigurojë një kuadër ligjor të përshtatshëm për shkeljet e detyrimeve të kompanive dhe OJF-ve dhe zbatimin e sanksioneve proporcionale dhe bindëse*”.

Në praktikë, bazuar në përgjigjen e marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit, gjithsej janë **2,377 OJF** të cilat kanë regjistruar pronarët e tyre përfitues. Për vitin 2022 numri i OJF-ve që kanë regjistruar pronarë përfitues është **393 OJF**. Që nga hyrja në fuqi e ligjit, janë lëshuar 118 sanksione administrative, me një shumë totale prej rreth 17,3 milionë Lekësh (përafërsisht 145,000 Euro), për shkelje të neneve 13 dhe 15 të ligjit. Në vitin 2022 janë dhënë 69 sanksione administrative për OJF-të, me një shumë totale prej 4.8 milionë Lekësh (përafërsisht 40,000 Euro) për të njëjtat lloje shkeljesh. Arsyet kryesore për këto shkelje janë mungesa e një fushate ndërgjegjësuere nga autoritetet, si dhe mungesa e qartësisë së OJF-ve mbi procedurat e regjistrimit.

Gjatë vitit 2022, sipas përgjigjes së marrë nga DPT-së, janë lëshuar 48 sanksione administrative për OJF-të, për arsyet e mëposhtme të paraqitura në tabelën 1.

Tabela 1: Natyra dhe numri i sanksioneve

Arsyeja	Numri i sanksioneve
Gjobë për mosdeklarim të punonjësve	12
Gjobë për lëshimin e faturës së gabuar të TVSH-së	2
Gjobë për mbajtjen e gabuar të të dhënave kontabël, dokumenteve etj.	1
Evazioni Fiskal	1
Gjobë për mosinstalimin e pajisjes elektronike për faturat dhe certifikimin dixhital	1
Gjobë për mospagimin e kësteve të tatimit mbi fitimin	4
Sanksion për mosdhënie informacioni	20
Mosdeklarimi i ndryshimeve të të dhënave të regjistrimit të OJF-ve	2
Gjobë për evazion fiskal për tatimin e qirasë	5
Totali	48

Krahasuar me Raportin e MM 2021, gjobat janë rritur më shumë se tre herë.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2022 ishte publikimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve ndaj Financimit të Terrorizmit, në bazë të së cilës niveli i rrezikut për sektorin e OJF-ve vlerësohet I ULËT (Partnerët Shqipëri, 2022).

Metodologjia u përgatit nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, bazuar në një Memorandum Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) që mbështeti financiarisht procesin. Ai u zhvillua përmes një përjasjeje bashkëpunuese me pjesëmarrjen e OJF-ve, autoriteteve shtetërore dhe institucioneve financiare. Publikimi është pjesë e një reagimi ndërkombëtar të OJF-ve për të mbrojtur hapësirën qytetare dhe për të adresuar mbi-rregullimin e OJF-ve në emër të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftës kundër Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT), në përputhje me qasjen e targetuar, bazuar në rrezik dhe proporcionale sikundër kërkohet sipas Rekomandimit 8 të FATF-së për OJF-të. Tani pritet që Njësia e Inteligjencës Financiare Shqiptare ta miratojë dhe ta integrojë zyrtarisht atë si pjesë e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut në lidhje me çështjet PPP/LFT. Me këtë metodologji, e cila është në përputhje me kërkesat e FATF-së, Shqipëria përmbush një nga rekomandimet e MONEYVAL për OJF-të. Nisur nga këto zhvillime, një nga ndryshimet kryesore të pritshme në legjislacion është deklasifikimi i sektorit të OJF-ve si me “rrezik të lartë” nga ligji i PPP-së.

1.1.3. Sigurimi i Burimeve Financiare

Gjatë vitit 2022, nuk ndodhën ndryshime ligjore në këtë fushë. Kuadri ligjor u mundëson OJF-ve të kërkojnë dhe të sigurojnë fonde nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja, përfshirë dhurime nga individë dhe korporata, si dhe të ushtrojnë aktivitet ekonomik. OJF-të mund të krijojnë ndërmarrje sociale për të rritur qendrueshmërinë e tyre financiare, por

kuadri ligjor për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale nuk është mundësues. Ai paraqet procedura dhe rregullore të paqarta regjistrimi për OJF-të, siç raportohet në dokumentin e fundit të politikave “Statusi i ndërmarrjes sociale – paqartësitë dhe mundësitë për përmirësim” të përgatitur nga Partnerët Shqipëri gjatë vitit 2022.

Në vitin 2007 u krijuar Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU) përgjegjëse për menaxhimin administrativë, financiar dhe teknik të projekteve të miratuara në përputhje me marrëveshjet financiare midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian, Bankës Botërore dhe donatorë të tjerë⁵. Bazuar tek përgjigjet e dhëna nga CFCU-ja, për Programet Kombëtare IPA 2014, IPA 2015 dhe IPA 2017, ky autoritet ka menaxhuar gjithsej 34 kontrata projektsh, përkatësisht 12 kontrata në kuadër të programit IPA 2014, 13 kontrata nën programin IPA 2015 dhe 9 kontrata nën IPA 2017. Procesi i disbursimit të fondeve nga miratimi i raporteve (narrative dhe financiare) varion nga 7-14 ditë, dhe numri mesatar i vizitave monitoruese ka qenë dy.

Në praktikë, organizatat që zbatojnë projekte për të cilat CFCU-ja është autoriteti kontraktues kanë raportuar disa shqetësime. Një nga shqetësimet më të shpeshta është vonesa joreale e miratimit të raporteve (ndërmjet 4-12 muaj), e cila ndikon ndjeshëm kalendarin e disbursimeve të fondeve dhe pengon zbatimin e projektit. Procesi i shqyrtimit të raporteve ka evidentuar njohuri dhe kuptim të dobët të kornizës ligjore të OJF-ve nga stafi i CFCU-së, dhe kërkesa joreale të cilat nuk janë harmonizuar si pjesë e protokollit të monitorimit të CFCU-së.

Faqja e internetit e CFCU-së është krijuar në vitin 2020 dhe ofron informacion të limituar mbi rolin dhe funksionimin e saj, si dhe shumë pak transparencë në lidhje me projektet e financuara, organizatat zbatuese dhe mbi dokumentacionin lidhur mbi rregullat dhe procedurat për menaxhimin e kontratave.

Nën-fusha 1.2. Liritë e tjera

1.2.1 Liria e tubimeve paqësore

E drejta e lirisë së tubimit garantohej me ligj për të gjithë personat fizikë dhe juridikë. Në prill 2022, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale publikoi Urdhrin nr. 9/5, datë 01.04.2022, në bazë të të cilit hiqen të gjitha kufizimet e pandemisë COVID-19 në lidhje me kufizimin e lirisë së tubimit (Fletore Zyrtare 51/2022). Në bazë të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, të depozituar në Kuvendin e Shqipërisë, vihet re një numër i lartë i personave të shoqëruar nga policia e shtetit, veçanërisht gjatë tubimeve të ndryshme. Probleme të tjera lidhen me praninë e punonjësve të policisë pa uniforma dhe dokumente të dukshme identifikimi, numrin e madh të veprave penale që u atribuohen të arrestuarve nga punonjësit e policisë me qëllim justifikimin e ndalimit dhe intimidimin e qytetarëve për të marrë pjesë në tubime. Gjithashtu, ka pasur probleme gjatë monitorimit të tubimeve nga mediat, ku punonjësit e medias nuk u lejohet të kryejnë detyrën nga punonjësit e policisë,

⁵ <https://cfcu.financa.gov.al/>

si shoqërimi i tyre, marrja e pajisjeve të filmimit dhe fotografimit, apo fshirja e tyre⁶. Si çdo vit për përgatitjen e Raportit të MM-së, PSh dërgoi një kërkesë për informacion drejtuar Policisë së Shtetit për ushtrimin e lirisë së tubimit paqësor nga qytetarët dhe OJF-të, por për të dytin vit radhazi institucioni nuk ktheu përgjigje.

1.2.2 Liria e Shprehjes

Një zhvillim pozitiv gjatë vitit 2022 ishte tërheqja e projektligjeve të diskutueshme për median, e njohur si paketa “anti-shpifje” nga agjenda parlamentare. Paketa ligjore u kundërshtua gjerësisht nga mediat, organizatat e shoqërisë civile, partnerët ndërkombëtarë. Komisioni i Venecias në opinionin të tij e konsideroi atë si një nismë që cënon lirinë e shprehjes. Në shtator 2022 u publikua projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive” me qëllim transpozimin e Direktivës së BE-së 2018/1808. Ai parashikon disa rishikime të rregullave për transmetuesit audiovizivë, si dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove, mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, përfshirjen e rregullave për sigurimin e aksesit në informacion të personave me aftësi të veçanta, rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, dhe përfshirjen e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesës. Ai trajton koncepte të reja si bashkërrëgjuesimi, vetërrëgjuesimi dhe edukimi mediatik. Projektligji pritet të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2023.

Në praktikë, Shqipëria vijon të përjetojë një përkeqësim të lirisë së medias. Shqipëria u rendit në vendin e 103-të nga 180 vende në Raportin e Reporterëve pa Kufij⁷, një përkeqësim me 20 vende nga viti paraardhës. Nuk është bërë asnjë progres në përmirësimin e mjedisit për gazetarinë e pavarur dhe investigative apo pluralizmin mediatik. Shpifja mbetet vepër penale, edhe pse nuk dënohet me burgim.

1.2.3. E drejta për të marrë dhe ndarë informacione të sigurta përmes çdo media

Kuadri ligjor ofron mundësinë e komunikimit dhe aksesit në çdo burim informacioni, përfshirë internetin dhe TIK-un. Gjatë vitit 2022 nuk ka patur ndryshime dhe kuadri ligjor reflekton gjetjet e Raportit të MM 2021 (Partnerët Shqipëri, 2022).

Nga vëzhgimi i kryer nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri me 115 OJF, 68% e OJF-ve vlerësojnë të aksesueshme median lokale (36% e aksesueshme dhe 32% shumë e aksesueshme), ndërsa aksesit në median kombëtare është raportuar si nga 43% e OJF-ve të anketuara (12% shumë e aksesueshme dhe 31% e aksesueshme).

Mediat sociale vijojnë të mbeten ndër kanalet më të përdorura të komunikimit nga OJF-të. Facebook renditet si kanali më i përdorur nga 94% e OJF-ve.

⁶ <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/17f53d7d-ee0d-415b-8457-96cf1007d263>

⁷ <https://rsf.org/en/index>

Fusha 2: Kuadri për Qendrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OJF-të

Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor/fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre

2.1.1. Përfitimet tatimore

Gjatë vitit 2022, ligji “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” u amendua përmes ligjit nr. 82/2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, të ndryshuar, i cili do të hyjë në fuqi në janar 2023 (Fletore Zyrtare, 170/2022). Para këtij ligji, OJF-të rimburohen për TVSH-në e akumuluar lidhur me zbatimin e projekteve të financuara nga të gjitha marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë ose marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Me ndryshimin e ligjit të ri, pritet që OJF-të të përjashtohen nga TVSH-ja. Në praktikë, zbatimi i procedurës së rimbursimit të TVSH-së për grantet e donatorëve të huaj mbetet sfidues. Gjatë vitit 2022, janë lëshuar vetëm tre vërtetime për rimbursimin e TVSH-së dhe 2 OJF janë rimbursuar.

Ligji nr. 83/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar prezanton kufijtë e lejueshëm ditor të parave fizike (cash). Si standard, kufiri maksimal i parave në dorë varet nga niveli i qarkullimit vjetor të tatimpaguesit që lëshon faturë. Sipas këtij ndryshimi, nëse qarkullimi vjetor i një viti më parë është më pak se 2 milionë Lekë (përafërsisht 16,800 Euro), kufiri i parave fizike është deri në 150,000 Lekë (përafërsisht 1,300 Euro); nëse është midis 2 – 10 milionë Lekësh (përafërsisht 16,800 – 84,000 Euro), kufiri i parave fizike është deri në 500,000 Lekë (përafërsisht 4,200 Euro) dhe nëse është mbi 10 milionë Lekë (rreth 84,000 Euro) kufiri i parave fizike është deri në 500,000 Lekë (përafërsisht 4,200 Euro) ose 5% e qarkullimit vjetor të vitit të kaluar, cilado qoftë vlera më e lartë. Nëse aktiviteti ka filluar gjatë vitit aktual, kufijtë e parave fizike vlerësohen në bazë të parashikimit të tatimpaguesit, bazuar në fashat e mësipërme (Fletore Zyrtare 173/2022).

OJF-të që kryejnë aktivitete ekonomike deri në nivelin e 20% të të ardhurave totale vjetore nuk i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat, përveç rasteve kur të ardhurat e krijuara nga aktiviteti ekonomik nuk përmbushin qëllimin e organizatës. Mungojnë incentivat fiskale për OJF-të që kanë statusin e “ndërmarrjes sociale”. Interesat bankare si formë e investimeve pasive janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat. Gjithashtu, legjislacioni për tatimin mbi të ardhurat nuk i përjashton shprehimisht të ardhurat e OJF-ve nga veprimet aksionere. Të ardhurat në formën e dividendëve (për aksionet e zotëruara në një kompani) përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat kur shoqëria që bën shpërndarjen i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat. Ky përjashtim është i vlefshëm pavarësisht përqindjes së aksioneve të zotëruara në shoqëri nga aksioneri (Hoxha. J., 2020). Shqipëria nuk ka një ligj për dhurimet e kushtëzuara.

2.1.2. Stimuj për dhurimin individual/korporativë

Kuadri ligjor që rregullon dhurimet nuk ndryshoi gjatë vitit 2022. Ndryshimi i ligjit për sponsorizimin është përfshirë si masë që do të zbatohet deri në fund të vitit 2023 në Udhëzuesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për Mjedisin Mundësues për Shoqërinë Civile 2019-2023. Mungojnë lehtësirat tatimore lidhur me veprimtarinë filantropike të individëve. Gjithashtu, nuk ka një strategji ose politikë shtetërore të vendosur në lidhje me Përgjegjësinë Sociale Korporative (PSK).

Në praktikë, gjatë vitit 2022, Partnerët Shqipëri identifikoi 616 fushata për mbledhjen e fondeve nga individë dhe korporata përmes monitorimit të Veprimtarisë Filantropike nëpërmjet Medias dhe Platformave Online (Partnerët Shqipëri, 2023). Vlera e dhurimeve është 460 milionë Lekë (përafërsisht 3,8 milion Euro). Krahasuar me Raportin e MM 2021, shuma e dhurimeve është rritur dy herë, dhe 32.5% e këtyre dhurimeve (200 fushata për mbledhjen e fondeve) janë kanalizuar përmes OJF-ve. Ka praktika ku PSK-ja ka kontribuar në mbështetjen e kauzave sociale të OJF-ve.

Nën-fusha 2.2. Mbështetja e shtetit

2.2.1. Disponueshmëria e financimit publik

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mbetet institucioni kryesor publik që rregullon mbështetjen shtetërore për zhvillimin institucional, mbështetjen e projekteve dhe mbështetjen e bashkë-financimit. Organizimi dhe funksioni i saj është në përputhje me ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile". Buxheti vjetor i shtetit siguron një ndarje të fondeve publike për të mbështetur shoqërinë civile (që përfshin planifikimin, menaxhimin dhe administrimin). Gjithashtu, ka edhe institucione të tjera publike që kanë dhënë fonde në formën e granteve për OJF-të gjatë vitit 2022. Më poshtë është paraqitur një tabelë e agjencive shtetërore që i janë përgjigjur kërkesës për informacion të dërguar nga Partnerët Shqipëri për mbështetjen publike dhe fondet përkatëse të dhëna prej tyre.

Tabela 2: Financimi publik nga institucione publike në nivel qendror.

Institucionet	Numri i thirrjeve për projekt propozime	Aplikimet e dorëzuara në total	OJF-të fituese	Shuma minimale dhe maksimale për grant	Shuma totale e shpërndarë gjatë vitit 2022
AMSHC	1	161	62	Maks.: 2 milion Lekë (përaf. 16,800 Euro)	95 milion Lekë (Përaf. 795,000 Euro)
Ministria e Mbrojtjes	0	3	2	Min.: 800,800 Lekë (përaf. 6,700 Euro) Maks.: 1,487,200 Lekë (përaf. 12,500 Euro)	2.288.000 Lekë (përaf. 19,000 Euro)
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	90	23	N/A	45,399,450 Lekë (përaf. 380,000 Euro)
Ministria e Kulturës	1	231	130	Min.: 200,000 Lekë (përaf. 1,700 Euro) Maks.: 3,200,000 Lekë (përaf. 27,000 Euro)	122,317,600 Lekë (përaf. 1 milion Euro)
Ministria e Drejtësisë	1	3	0	Maks.. 1,600,000 Lekë [(përaf. 13,500 Euro); (20% e fondit total)]	8,000,000 Lekë (përaf. 66,600 Euro)
Agjencia Kombëtare e Rinisë ⁸	1	N/A	24	N/A	N/A
Ministria e Arsimit dhe Sportit	N/A	N/A	24 ⁹	N/A	N/A

⁸ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë <http://rinia.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/liste-ojf-fitues.pdf>

⁹ 18 Federata Olimpikë, 3 Federata Joolimpikë, Komiteti Olimpik Kombëtar, Organizata Kombëtare Antidoping dhe Federata Kombëtare e Futbollit.

Në nivel vendor, financimi publik nga bashkitë paraqitet në tabelën 3¹⁰.

Tabela 3: Financimi publik nga institucionet publike në nivel vendor.

Bashkia	Numri i thirrjeve për projekt propozime	Aplikimet e dorëzuara në total	OJF-të fituese	Shuma minimale dhe maksimale për grant	Shuma totale e shpërndarë gjatë vitit 2022
Memaliaj	N/A	N/A	1	N/A	3,500,000 Lekë (përaf. 29,500 Euro)
Përmet	3	N/A	8	Min.: 500,000 Lekë (përaf. 4,200 Euro) Maks.: 2,000,000 Lekë (përaf. 16,800 Euro)	9,500,000 Lekë (përaf. 80,000 Euro)
Gramsh	1	4	4	Min.: 50,000 Lekë (përaf. 420 Euro) Maks.: 200,000 Lekë (përaf. 1,700 Euro)	400,000 Lekë (përaf. 3,300 Euro)
Roskovec	1	3	1	N/A	998,100 Lekë (përaf. 3,800 Euro)
Lushnje	1	N/A	5	Min.: 100,000 Lekë (përaf. 840 Euro) Maks.: 500,000 Lekë (përaf. 4,200 Euro)	N/A
Korçë	1	2	1	N/A	2,000,000 Lekë (përaf. 16,800 Euro)
Shkodër	1	16	7	N/A	7,239,000 Lekë (përaf. 60,000 Euro)
Kukës	1	27	5	N/A	737,393 Lekë (përaf. 6,200 Euro)
Himarë	1	2	2	Min.: 800,000 Lekë (përaf. 6,700 Euro) Maks.: 2,000,000 Lekë (përaf. 16,800 Euro)	2,800,000 Lekë (përaf. 23,500 Euro)

Thirrja e AMSHC-së trajtonte katër prioritetë, të cilat ishin: shërbimet shëndetësore dhe sociale; lufta kundër korrupsionit dhe edukimi ligjor publik dhe SKZHI-së; mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm; arsimit dhe integrimi evropian. Ministria e Drejtësisë shpalli një thirrje për projekt propozime për të mbështetur OJF-të e licencuara nga ministria për të ofruar ndihmë juridike falas. Asnjë nga tre organizatat që aplikuan nuk u shpallën fituese në këtë thirrje për projekt propozime për shkak se komisioni vlerësues nuk u krijua brenda afateve të përcaktuara në vendimin e Ministrit të Drejtësisë. Fondi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit mbulon vetëm 50% të kostove të pranueshme të miratuara nga ministria.

¹⁰ Të dhënat të marra nga bashkitë të cilat u përgjigjën kërkesës për informacion të PSh-së.

Grantet me financim publik mbeten të kufizuara, dhe mbështesin projekte afatshkurtra. Përafërsisht 10% e OJF-ve aktive kanë marrë grante nga institucionet kombëtare. Nuk ka raste të mbështetjes institucionale me fonde publike, edhe nga AMSHC-ja ku mbështetja institucionale renditet si një lloj mbështetjeje për organizatat e shoqërisë civile.

2.2.2. Shpërndarja e financimit publik

Në përputhje me ligjin për AMSHC-në dhe rregulloren mbi procedurat e financimit me grante në mbështetje të shoqërisë civile, AMSHC-ja vë në dispozicion të gjithë informacionin në lidhje me procedurën e granteve. Shpallja e procedurës është publike, si dhe jep kohë të mjaftueshme për përgatitjen (më shumë se 30 ditë) dhe dorëzimin e projekt propozimeve dhe të gjithë dokumentacionit të kërkuar. Për vitin 2022, AMSHC-ja ka organizuar katër takime konsultative me OJF-të për të përcaktuar prioritetet e thirrjes për projekt propozime¹¹.

Në nivel ministrish, i gjithë procesi rregullohet përmes VKM-ve, të cilat përcaktojnë fushat e mbështetjes, kriteret e përzgjedhjes, formularët e aplikimit, procedurat e vlerësimit e përzgjedhjes, afatet e aplikimit, çështjet e konfliktit të interesit, etj. Për shembull, financimi publik nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit rregullohet përmes VKM nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe afateve të thirrjes për propozime për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” (Fletore Zyrtare, 69/2016). Fondet nga Ministria e Drejtësisë rregullohen me VKM nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara për të ofruar ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti, të cilat përfitojnë financim nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit”. Në lidhje me fondet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, në korrik 2022, Këshilli i Ministrave miratoi VKM nr. 566, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave dhe organizatave rinore që punojnë me të rinjtë, të cilat përfitojnë nga skema e financimit të granteve për të rinjtë nga buxheti i shtetit” (Fletore Zyrtare, 114/2022).

2.2.3. Llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi i financimit publik.

Neni 22 i ligjit nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” parashikon që AMSHC-ja të vërë në dispozicion të publikut procedurat e përzgjedhjes, kontratat e lidhura ndërmjet autoritetit kontraktor dhe përfituesit, si dhe raporte për shpenzimet e fondeve. Gjithashtu, “Rregullorja mbi Procedurat e Financimit me Grante për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”¹² e AMSHC-së parashikon një departament të veçantë në strukturën e Agjencisë për të monitoruar të gjitha projektet që financohen nga Agjencia. Për projektet rinore, neni 21 i VKM nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave dhe organizatave rinore që punojnë me të rinjtë që përfitojnë nga skema e

¹¹ <https://amshc.gov.al/per-realizimin-e-takimeve-ne-kuader-te-konsultimeve-per-thirrjen-e-rradhes-te-agjencise-per-mbeshtetjen-e-shoqerise-civile/>

¹² <https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim-per-Miratimin-e-Rregullores-Mbi-Procedurat-e-Financimit-Me-Grante.pdf>

financimit të të rinjve nga buxheti i shtetit” përcakton rregulla të qarta për raportimin, monitorimin dhe vlerësimin e granteve në fushën e rinisë. Sipas pikës 3 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Rinisë duhet të bëjë një vlerësim vjetor të performancës së granteve në fushën e rinisë, i cili përfshin vlerësimin në lidhje me menaxhimin e thirrjes për projekt propozime, si dhe rezultatet dhe ndikimet e arritura nga projektet e financuara.

Në praktikë, bazuar në përgjigjen e saj, AMSHC-ja kryen monitorim të vazhdueshëm të çdo projekti të financuar, duke përfshirë si aspektin narrativë ashtu edhe atë financiar. Nuk është bërë asnjë vlerësim për ndikimin e financimit publik në mbështetje të veprimtarisë së OJF-ve. AMSHC-ja është i vetmi institucion publik që publikon raporte monitoruese tremujore për performancën financiare, por nuk pasqyron ecurinë e projekteve të financuara nga Agjencia.

2.2.4. Mbështetje jo financiare

Autoritetet shtetërore kanë mundësi të ofrojnë mbështetje jo-financiare për OJF-të duke ofruar mjedise publike pa pagesë, konsulencë dhe asistencë për ngritje kapacitetesh, etj. Bazuar në përgjigjet e marra nga ministritë e linjës, vetëm Ministria e Kulturës nga tetë (8) ministri që dërguan informacion ka ofruar mbështetje të ngjashme jofinanciare për OJF-të. Në nivel vendor vetëm ¹³ nga 38 bashki që iu përgjigjën kërkesës së PSH-së për informacion, kanë ofruar mbështetje jofinanciare, e cila ka konsistuar në ofrimin e mjediseve publike pa pagesë.

Rregulloret në fuqi parashikojnë OJF-të si një ndër subjektet që përfitojnë nga ripërdorimi i pronave të konfiskuara, duke njohur vlerën e tyre si palë e rëndësishme interesi në adresimin e çështjeve sociale dhe zhvillimin e ekonomisë lokale. Në vitin 2016 praktika e ripërdorimit social të pronave të konfiskuara u prezantua nga PSh përmes projektit CAUSE. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) i vë në dispozicion të OJF-ve këto prona për një periudhë 5 – vjeçare pa pagesë dhe mundësi vijueshmërie aktiviteti. Aktualisht janë tre prona të konfiskuara që përdoren për qëllime sociale nga OJF-të dhe pritet që në vitin 2023 pasuri të tjera të konfiskuara t'u jepen OJF-ve për ripërdorim social, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet AAPSK dhe OJF-ve që zbatojnë komponentin “Mbështetje për sipërmarrjen sociale dhe ripërdorimin e pasurive të konfiskuara”, financuar nga Bashkimi Evropian.

¹³ Bashika e Devollit, Dibrës, Kukësit, Lezhës dhe Vorës.

Nën-fusha 2.3. Burimet Njerëzore

2.3.1. Punësimi në OJF

Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë nuk ndryshoi gjatë vitit 2022. Bazuar në Kodin e Punës, OJF-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë. Sipas informacionit të marrë nga DPT-ja, në sektorin e OJF-ve, gjatë vitin 2022, janë të punësuar 11,972 punonjës.

2.3.2. Vullnetarizmi në OJF

Prej gjashtë vitesh nga miratimi i tij, ligji për vullnetarizmin nuk zbatohet për një sërë problematikash që ai përfaqëson, pasi nuk u konsultua me grupet e interesit dhe nuk u morën parasysh zhvillimet në vend.

Në shkurt 2022, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë i Kuvendit të Shqipërisë organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e qeverisë për ligjin e vullnetarizmit. Organizatat e shoqërisë civile janë informuar për këtë seancë dhe agjendë për diskutim vetëm nga faqja e Kuvendit.

Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri në bashkëpunim me Shoqatën Përtej Barrierave dhe Grupin e OShC-ve për Vullnetarizmin në Shqipëri, në vitin 2022, vijuan përpjekjet e tyre avokuese për përmirësimin e kuadrit ligjor për vullnetarizmin në Shqipëri. Si rezultat, më 29 mars u organizua një takim online me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Zëvendësministrin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe përfaqësues nga MFE-ja, gjatë së cilës u diskutua dhe u dakordua për themelimin e një grupi të përbashkët pune lidhur me rishikimin e ligjit. Grupi i punës u krijua në prill 2022 dhe kanë vijuar takime për të diskutuar ndryshimet e mundshme të ligjit. Diskutimet janë në vazhdim dhe ndryshimet e propozuara të grupit do të konsultohen me një grup më të gjerë OJF-sh dhe institucioneve shtetërore përpara se t'u paraqiten autoriteteve përkatëse për miratim. Paralelisht, me nismë të një deputeti të Partisë Opozitare, në tetor 2022 në Kuvendin e Shqipërisë u dorëzua një projektligj për vullnetarizmin.

2.3.3. Arsimi Jo-formal

Nuk ka pasur ndryshime ligjore lidhur me arsimin joformal. Angazhimi qytetar/vullnetarizmi trajtohet si temë e veçantë, pjesë e lëndës së edukimit qytetar në shkollën fillore. OJF-të janë të përfshira në ofrimin e arsimit joformal brenda dhe jashtë sistemit arsimor.

Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC

Nën-fusha 3.1. Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

3.1.1. Politikat dhe strategjitë shtetërore për zhvillimin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile

Strategjia kryesore për zhvillimin dhe bashkëpunimin e shtetit me shoqërinë civile është Udhërrëfyesi për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi Më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023. Në qershor 2022, në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), qeveria shqiptare bëri një prezantim të progresit në zbatimin e Udhërrëfyesit, sipas të cilit prioritetet strategjike janë arritur në një nivel mbi 60%. Procesi i monitorimit nuk ka qenë me pjesëmarrje dhe as OJF-të, anëtare të KKSHC-së nuk janë konsultuar në kundërshtim me VKM nr. 539, datë 25.07.2019 “Për Miratimin e Udhërrëfyesi për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi Më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023, të rishikuar”.

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile publikoi një raport mbi zbatimin e Udhërrëfyesit, duke ofruar të dhëna të faktuara për secilin prej masave. Përfundimi i këtij monitorimi tregoi se zbatimi i Udhërrëfyesit nuk është i përafërt me atë të raportuar nga Qeveria. Bazuar në një analizë të tillë, Udhërrëfyesi ka shkallën e zbatimit në një nivel prej rreth 20%. Mungesa e progresit në këtë drejtim u evidentua edhe në Raportin e Progresit të BE-së për Shqipërinë 2021.

3.1.2. Institucionet dhe mekanizmat për zhvillimin dhe bashkëpunimin me Shoqërinë Civile

Që nga viti 2015, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) është organi këshillues për dialogun dhe bashkëpunimin me OJF-të. Gjatë vitit 2022, KKSHC-ja ka organizuar dy mbledhje, në muajt qershor dhe nëntor (një më pak se numri i parashikuar në ligj). Në takimin e parë, çështjet e diskutuara u fokusuan në një analizë mbi monitorimin e Udhërrëfyesit 2019 – 2023 dhe Planin e Veprimit të tij; prezantimin e nismës së Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP), prezantimin e ligjit nr. 36/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”, nevojën për koordinim ndërmjet grupeve të punës për kryerjen e aktiviteteve për arritjen e prioritetëve të Udhërrëfyesit, financimin e OJF-ve dhe propozimet nga shoqëria civile mbi shtimin e një anëtari nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në KKSHC, adresimin e çështjeve që lidhen me fiskalizimin dhe taksat vendore me anëtarë nga Ministria e Financave, si dhe të hartimit të një liste të personave të caktuar si pika kontakti për punë grupe në ministrinë përkatëse.

Në takimin e nëntorit, çështjet e diskutuara u fokusuan në prezantimin e mundësive aktuale për bashkëpunim ndërmjet shoqërisë civile dhe Partneritetit për Qeverisjen e Hapur, prezantimin e Udhëzimeve të DG NEAR rreth mbështetjes së Bashkimit Evropian

për Shoqërinë Civile 2021 – 2027, diskutimin mbi ngritjen dhe ndarjen e grupeve të punës së KKSHC-së, si dhe propozime për kalendarin e aktiviteteve të KKSHC-së.

Informacioni i mësipërm është marrë nga AMSHC-ja në bazë të kërkesës për informacion dërguar nga PSh-ja. Nuk ka asnjë informacion publik në faqen e AMSHC-së për takimet dhe vijimësinë apo progresin në adresimin e çështjeve të diskutuara. Praktika e publikimit të procesverbaleve të mbledhjeve të KKSHC-së në faqen e AMSHC-së është deri në vitin 2020.

Një mekanizëm tjetër për bashkëpunim është Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian¹⁴. Sipas raportit vjetor të KKIE-së, gjatë vitit 2022 KKIE-ja ka organizuar 12 takime, 6 takime periodike dhe 6 takime sensibilizuese. Në përbërjen e tij janë 14 anëtarë nga përfaqësues të shoqërisë civile¹⁵, të gjithë me seli në Tiranë.

Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e vendimmarrjes dhe politikave

3.2.1 Standardet për përfshirjen e OJF-ve

Bazuar në ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik” u krijua regjistri elektronik i konsultimit publik www.konsultimipublik.gov.al në të cilën Qeveria dhe ministritë e linjës kryejnë konsultime me publikun. Parlamenti shqiptar ka krijuar [platformën](#) e tij të konsultimit.

Një mekanizëm tjetër për të siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian është Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian¹⁶, ku përfaqësuesit e shoqërisë civile mund të marrin pjesë në bordin drejtues të Platformës dhe 33 tavolina diskutimi dhe konsultimi. Gjatë vitit 2022 u miratua Plani Kombëtar për Integrimin Evropian¹⁷, i cili synon të koordinojë përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, duke synuar njëkohësisht përmbushjen e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe detyrimeve që dalin si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Një nga ndryshimet e paraqitura në metodologjinë e re është përfshirja dhe ofrimi i udhëzimeve për kryerjen e konsultimeve me shoqërinë civile në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrim Evropian¹⁸.

Në praktikë, ka informacion shumë të kufizuar për statusin e formimit të tryezave të diskutimit dhe nivelin e pjesëmarrjes së OJF-ve në këto tryeza. Faqja e internetit e Platformës nuk jep asnjë informacion për anëtarët apo procesverbalet e takimeve. Nga vëzhgimi i faqeve të ministrive të linjës, vetëm Ministria e Drejtësisë jep informacion mbi tryezat, procesverbalet dhe pjesëmarrësit që kontribuan në diskutim. Është e vetmja ministri që iu përgjigj kërkesës për informacion për këtë temë. Në maj të vitit 2022,

¹⁴ <https://web-api.parlament.al/Files/202301301526066803Raporti%20i%20KKIE%202022.pdf>

¹⁵ <http://www.parlament.al:5000/Files/202211041144382022P%C3%ABrberja%20e%20KKIE.pdf>

¹⁶ <https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/en/strukturat/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-evropian/>

¹⁷ https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/NPEI_2022-2024_EN-.pdf

¹⁸ Ibid, faqja 18

Ministria e Drejtësisë publikoi një thirrje të hapur për shprehje interesi për të marrë pjesë në tavolina dhe nga tryeza e kapitullit 23 u mbajtën tre takime, pjesë e të cilave janë edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe OJF-ve. Tabela 4 paraqet projektligjet e konsultuara ne regjistrin elektronik të konsultim publik gjatë vitit 2022.

Table 4: Konsultimet e kryera përmes regjistrit të konsultimit publik.

Ministritë	Konsultimet e publikuara 2022
Ministria e Arsimit dhe Sportit	2
Ministria e Ekonomisë dhe Financave	18
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	5
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	12
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	20
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	3
Ministria e Brendshme	4
Ministria e Mbrojtjes	2
Ministria e Kulturës	2
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	10
Ministria e Drejtësisë	11
Ministër i Shtetit dhe Kryenegociator	1
Ministër i Shtetit për Standardet e Shërbimeve	1

Nga vëzhgimi i kryer nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile me 115 OJF, 58% e tyre pohojnë se kanë informacion mbi platformën dhe strukturat integruese të krijuara në nivel ndërinstitucional dhe 46% e tyre janë përgjigjur se kanë kapacitete për të kontribuar në tryezat e diskutimeve. Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në procesin konsultativ legjislativ në përgjithësi, jo domosdoshmërisht e lidhur me tryezat e diskutimeve, 67% e OJF-ve raportojnë përfshirjen e tyre gjatë viteve 2021-2022. Shumica e organizatave që nuk kanë marrë pjesë ndodhen jashtë Tiranës (66%). Arsyet kryesore të dhëna për mospjesëmarrjen janë mungesa e njoftimeve dhe informacionit për procese të tilla, kufizimet kohore për shkak të njoftimit të shkurtër, ngarkesa e punës, konsultimet nuk lidhen me fokusin e punës së organizatës dhe mungesa e konsideratës për kontributin e dhënë më parë.

I vetmi institucion që ka një koordinator për shoqërinë civile është Kuvendi i Shqipërisë. Ky informacion është bërë publik në faqen e Kuvendit. Të gjitha ministritë dhe bashkitë që iu përgjigjën kërkesës së PSh-së për informacion nuk kanë koordinatorë të tillë.

3.2.2 Qasja e publikut në draft politika dhe ligje

Në tetor 2022, Ministria e Drejtësisë publikoi një projektligj “Për të Drejtën e Informimit”, duke paraqitur një sërë ndryshimesh thelbësore si futja e konceptit të “kërkesave

abuzive”, ulja e gjobave ndaj autoriteteve publike që refuzojnë të kthejnë përgjigje, etj. Ky projektligj u kundërshtua nga OJF-të dhe përfaqësuesit e medias si shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtës së publikut për informim, duke treguar një zvogëlim të hapësirës për aktivizmin qytetar. Procesi i konsultimit për këto ndryshime ka qenë i hapur deri në fund të vitit 2022.

Sipas raportit vjetor të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹⁹, numri i ankesave ka vijuar të rritet ndjeshëm gjatë vitit 2022, duke arritur në 1032 ankesa. Pjesa më e madhe e ankesave kanë të bëjnë me mosdhënien e informacionit, ku 67% e tyre janë në nivel vendor. OJF-të kanë paraqitur 196 ankesa në vitin 2022. Mungesa e shtuar e përgjigjes nga institucionet është vërejtur edhe nga Partnerët Shqipëri gjatë këtij viti kur për kërkesat për informacion të dërguara në linjat e ministrive dhe bashkive u janë përgjigjur vetëm 8 nga linjat e ministrive dhe 38 bashki.

Në vitin 2022, vetëm 89% e autoriteteve publike kanë publikuar Programin e Transparencës dhe 374 autoritete publike kanë caktuar një koordinatör për të drejtën e informimit.

3.2.3. Përfaqësimi i OJF-ve në organet ndërsektoriale

Legjislacioni ekzistues kërkon që institucionet publike të ftojnë përfaqësues të OJF-ve në organet vendimmarrëse. Në bazë të përgjigjes së MEF-it, përfaqësuesit e OJF-ve janë anëtarë të Këshillit Koordinues për Çështjet e Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili analizon strategjitë dhe masat organizative për mbrojtjen e konsumatorëve në përputhje me ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, të ndryshuar. Këshilli Koordinues përbëhet nga përfaqësues të organeve të administratës shtetërore që lidhen drejtpërdrejtë ose tërthorazi me mbrojtjen e interesit të konsumatorit, si dhe nga shoqatat jofitimprurëse të konsumatorëve dhe biznesit. Katër anëtarë janë përfaqësues të OJF-ve.

Një organ tjetër është Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar. Këshilli është një organ këshillimor i ministrit për politikën e zhvillimit të arsimit parauniversitar, i krijuar në bazë të nenit 29 të ligjit nr.69/12 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ai përbëhet nga 16 anëtarë, dhe një anëtar është nga sektori i OJF-ve. Këshilli jep mendime për a) hartimin e strategjive, programeve kombëtare dhe akteve ligjore; b) projektbuxhetin për arsimin parauniversitar; c) çështje të tjera të politikave arsimore, me kërkesën e theksuar nga ministri.

Një organ tjetër i krijuar është Këshilli i Lartë i Sportit, përfaqësuesit e të cilit caktohen me Urdhër nr. 396 datë 08.07.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”. Tre anëtarë janë nga sektori i OJF-ve.

Në fushën e bujqësisë, OJF-të përfshihen në grupet e punës për hartimin e bazës ligjore të institucionit. Kështu, për vitin 2022, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përfshirë OJF-të në: Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021-2027; Ligji “Për vreshtin dhe verën” Ligji “Për bletarinë”; Ligji për “Grupet Lokale të Veprimit”.

¹⁹ <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti-Vjetor-2022.pdf>

Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

3.3.1. Angazhimi i OJF-ve në ofrimin e shërbimeve dhe konkurrenca për kontratat shtetërore

Gjatë vitit 2022 nuk ka patur ndryshime ligjore mbi prokurimet sociale. Ligji dhe rregulloret në fuqi përcaktojnë llojet e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, për të cilat organizatat mund të rezervojnë të drejtën për të marrë pjesë në thirrjet e prokurimit publik. Në praktikë, bazuar në përgjigjen e marrë nga Agjencia e Prokurimit Publik, në vitin 2022 është publikuar vetëm një thirrje për prokurim për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike. Objekti i prokurimit ishte “Filmimi, transmetim live dhe media për ekipet sportive 2022”. Subjekti fitues ishte përfaqësues nga sektori privat.

Për sa i përket licencimit, sipas informacionit të marrë nga ministritë e linjës, janë 15 OJF të licencuara për të ofruar ndihmë juridike falas nga Ministria e Drejtësisë, 7 OJF të licencuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe 96 subjekte (publike dhe jopublike) janë licencuar për ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga MShMS-ja. Çdo nevojë për licencim nga OJF-të mundësohet përmes kuadrit ligjor në fuqi.

3.3.2. Financimi i shërbimeve sociale

Për vitin 2022, autoritetet publike të mëposhtme kanë kontraktuar shërbime nga OJF-të:

Table 5. Kontratat e shërbimeve për OJF-të

Institucionet	OJF-të e shpërblyera	Shuma minimale dhe maksimale për grant	Shuma totale e shpërndarë VF 2022
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	3	Min.: 826,223 Lekë (përaf. 7,000 Euro) Maks.: 1,327,030 Lekë (përaf. 11,000 Euro)	3,139,893 Lekë (përaf. 26,300 Euro)
Bashkia Shkodër	4	Min.: 50,000 Lekë (përaf. 420 Euro) Maks.: 2,021,000 Lekë (përaf. 17,000 Euro)	4,128,000 Lekë (përaf. 34,700 Euro)
Bashkia Durrës	1	642,000 Lekë (përaf. 5,400 Euro)	642,000 Lekë (përaf. 5,400 Euro)
Bashkia Dibër	1	960,000 Lekë (përaf. 8,000 Euro)	960,000 Lekë (përaf. 8,000 Euro)

Shërbimet janë kontraktuar duke përdorur fondet e projekteve të huaja për të ofruar shërbime sociale dhe psikologjike, aktivitete sportive dhe kosto të tjera bazë (transport, telefona, pije freskuese).

3.3.3. Procedurat për kontraktimin e shërbimeve

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 15.12.2021 prezantoi një procedurë të thjeshtuar për shërbimet sociale dhe të tjera specifike për të cilat jepet pjesëmarrja e OJF-ve në procedurat e prokurimit, në përputhje me direktivat e BE-së.

3.3.4. Llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi i Shërbimeve

Përgjegjësia, monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve janë në përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr.710 datë 24.11.2021.

Referencat

Kuvendi i Shqipërisë (2022), Ligji 82/2022 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 92/2014 për TVSH- në" të ndryshuar. Fletore zyrtare 170/2022. I aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2022/11/24/82/5bf33d53-8ebe-4fd6-a3ba-e502c6a1b892>.

Kuvendi i Shqipërisë (2022), Ligji 83/2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9920, datë 19.05.2018 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar. Fletore Zyrtare 173/2022. I aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2022/11/24/83/b3fec37a-c447-4e9f-b6b6-3d0c5d3f2ee6>

Vendim i Këshillit të Ministrave (2022), Vendim nr. 94, datë 9.02.2022 "Për rregullat e detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore që regjistrohen në regjistrin elektronik të OJF-ve, rregullat e detajuara për ofruesit e informacionit, ndërveprimet me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesit të subjekteve të interesuara. Fletore Zyrtare 23/2022. I aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/02/09/94/815d9ea4-65b2-400d-b51e-e39b4674418d>

Këshilli i Lartë Gjyqësor (2022), Vendimi nr.35, datë 26.01.2022 "Për krijimin dhe funksionimin e Regjistrat Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse". Fletore Zyrtare 17/2022. I aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/01/26/35/af554540-b05d-4ac0-bdbe-659c59b57f8c>

Hoxha. J., (2020), Mjedis i Ligjor për Filantropinë në Evropë, Raporti i për Shqipërinë 2020. Dafne - EFC Philanthropy Advocacy 2020. I aksesueshëm në: https://www.partnersalbania.org/wpcontent/uploads/2021/03/Albania_2020LegalPhilanthropyEnvironment.pdf

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2015), Urdhër nr. 62, datë 17.09.2015 "Për shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve dhe zbatimin e detyrueshëm të tij. Fletore Zyrtare 171/2015. I aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2015/09/17/62/23a3bc4c-b8ef-4c4c-82db-abb156fe36bd>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2022). *Për shfuqizimin e Urdhrit nr. 633, datë 17.11.2020 "Për ndalimin e tubimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar.* Fletore Zyrtare 51/2022. I aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2022/04/01/9-5/21b6c51b-9b25-46c5-9c45-acdba5085539>

Partnerët Shqipëri (2023). *Revista Filantropi*. I aksesueshëm në: <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2023/02/revista-ediconi-5-ang.pdf>

Partnerët Shqipëri (2022). *Metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut të Financimit të Terrorizmit për Sektorin e OJF-ve në Shqipëri*. I aksesueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/publication/terrorist-financing-risk-assessment-methodology-for-the-npo-sector-in-albania/>

Partnerët Shqipëri (2022). *Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti i Përmbledhës për Shqipërinë 2021*. I aksesueshëm në: <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2021/>